



RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË
RRUGËN “HAMDI CENOJMERI”, TIRANË”

Hartoi: Ledjana BOJAXHI | Nr. Identifikimi 120, Nr.4975 Prot., datë 04.07.2013 | Maj 2024

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'LJ' followed by a stylized flourish.

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. HYRJE	5
2. QËLLIMI I PROJEKTIT	5
3. KUADRI LIGJOR	8
3.1 Procedura e miratimit mjedisor	9
3.2 Kuadri i mbrojtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura	13
3.4. Mbrojtja e strukturës fizike	15
3.5 Shëndeti dhe siguria	23
3.6 Ligje të tjera kombëtare lidhur me planifikimin e territorit dhe përdorimin e tokës	25
3.7 Kuadri ligjor evropian	26
4. PËRSHKRIMI I MJEDISIT	27
4.1 Përshkrimi i mbulesës bimore	27
4.2 Burimet ujore në zonën e Tiranës	29
4.3 Mjedisi fizik	33
4.3.4 Biodiversiteti, flora dhe fauna	35
4.3.5 Mjedisi biologjik	37
4.3.6 Mjedisi Socio-Ekonomik	37
5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS	38
5.1 Ndikime të rëndësishme gjatë ndërtimit	38
5.2 Përmbledhja e impakteve potenciale negative	41
5.3 Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit	46
5.4 Ndikimet pozitive në mjedisin e zones së projektit	46
6. KOHËZGJATJA E MUNDSHME E NDIKIMEVE	47
7. MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	47
7.1 Masat kryesore lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndërtimit	47
7.2 Faza e projektimit	49

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN “HAMDI CENOJMERI”, TIRANË

7.3 Faza e ndërtimit	49
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT	50
8.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor.....	50
8.2 Objektivat e monitorimit	50
9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	51

FIGURAT

Figura 1 Ortofoto e vendodhjes, viti 2018.....	6
Figura 2 Procedura e VNM-së dhe afatet kohore sipas legjislacionit shqiptar.....	13
Figura 3 Pamje të gjendjes egzistuese	29
Figura 4 Harta e sistemit ujor	32
Figura 5 Harta hidrogeologjike e qarkut Tiranë	33

TABELAT

Tabela 1 Koordinatat e zonës së përzgjedhur	8
Tabela 2 Legjislacioni shqiptar për aplikimin e një VNM	8
Tabela 3 Legjislacioni shqiptar mbi biodiversitetin	13
Tabela 4 Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore	15
Tabela 5 Legjislacioni në lidhje me mbrojtjen e mjedisit fizik	16
Tabela 6 Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë	23
Tabela 7 Ligje të tjera kombëtare që kanë lidhje me planifikimin e territorit dhe përdorimin e tokës ..	25
Tabela 8 Shkarkimet në ujë	39
Tabela 9 Shkarkimet në ajër	39
Tabela 10 Ndikimet në tokë	40
Tabela 11 Ndikim në florën dhe faunën	40
Tabela 12 Shkalla e impaktit	42
Tabela 13 Kohëzgjatja e impaktit.....	42
Tabela 14 Impaktet potenciale negative	42
Tabela 15 Tabela përmbledhëse e impakteve.....	45
Tabela 16 Përmbledhje e ndikimeve positive në zonën e projektit	46

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN “HAMDI CENOJMERT”, TIRANË

Tabela 17 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve në mjedis	48
Tabela 18 Monitorimi i parametrave mjedisore	50

SHKURTIMET

VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
KRGJSH	Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ZM	Zona të Mbrojtura

1. HYRJE

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është një proces i cili kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis si pasojë e zbatimit të projekteve të propozuara publike dhe private. Përmes këtij procesi bëhet e mundur evidentimi, parashikimi dhe vlerësimi i efekteve gjatë dhe pas zbatimit të projektit mbi biodiversitetin, burimet ujore, trupat ujorë, ndikimet në cilësinë e mjedisit, ndikimet në terren, peisazhin si dhe ndikimin e tërësisë së këtyre faktorëve mbi trashëgiminë kulturore, njerëzit, shëndetin publik si dhe në aspektin ekonomik. Parimi mbi të cilin bazohet hartimi i raportit të VNM-së është “më mirë të parandalosh sesa të riparoj më pas”. VNM-ja mundëson parandalimin e efekteve negative, i jep përparësi ndikimeve pozitive duke mos lejuar dhe duke shmangur që në etapat e para të zbatimit ndikimet negative.

Lidhur me projektin “Rehabilitimi i emergjencës civile, mur mbajtës me pilota në rrugën “Hamdi Cenojmeri”, Tiranë”, do të hartohet një raport i cili përfshin vlerësimin, identifikimin, si dhe përcaktimin e masave zbutëse ndaj ndikimeve negative që shfaqen gjatë zbatimit të projektit.

2. QËLLIMI I PROJEKTIT

Gjendja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij, janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerëzimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarjeve operuese, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapësira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe tokë. Mbrojtja e mjedisit si një sistem dinamik që ndryshon herë pas herë fizikisht dhe biologjikisht, i duhen analizuar jo vetëm faktorët natyror, por edhe aktiviteti njerëzor i cili lidhet me to. Studimet dhe ndërtimet kur nuk menaxhohen konform ligjeve dhe rregullave të natyrës, ato mund të prishin ekuilibrin e natyrës përreth.

Raporti paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin “Rehabilitimi i emergjencës civile, mur mbajtës me pilota në rrugën ‘Hamdi Cenojmeri’, Tiranë” është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në dalje të zonës së kombinatit, duke ndjekur rrugën “Hamdi Cenojmeri” në drejtim të liqenit të Sharrës, konstatohen rrëshqitje të dheut që janë kthyer në problem për vetë rrugën por gjithashtu edhe për pronat në anë të saj. Për të pasur një qendrueshmëri të plotë, kundrejt rrëshqitjeve të tokës të cilat rrezikojnë pronën në tërësi të zhvilluesit, projekti i propozuar lidhet me ndërtimin e një muri mbajtës. Hartimi i këtij raporti është pjesë e dokumentacionit të kërkuar sipas VKM nr.9, datë 11.02.2024 “Për miratimin e

rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. I gjithë dokumentacioni i projektit, do dorëzohet pranë bashkisë Tiranë për t'u mbështetur financiarisht me fondet e emergjencave civile.

Në tërësi, ndërhyjet e propozuara në projekt do të jenë:

- a. Ndërtimi i murit mbajtës me pilota
- b. Zgjidhja e drenazhimit të rrugës
- c. Masa mbrojtëse inxhinierike
- d. Punime sistemimi të ambienteve të jashtme dhe punime për rehabilitimin e mjedisit




Figura 1 Ortofoto e vendodhjes, viti 2018

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN “HAMDI CENOJMERI”, TIRANË



Koordinatat e zonës që do të zbatohet projekti janë si vijon:

Tabela 1 Koordinatat e zonës së përzgjedhur

Projekti	Koordinatat sipas sistemit koordinativ Gauss Kruger Zone 4		Koordinatat sipas sistemit koordinativ KRGJSH	
	X	Y	X	Y
Koordinatat e fillimit të murit mbajtës	4398174.62	4575460.36	481789.12	4574636.89
Koordinatat e fundit të murit mbajtës	4398186.73	4575441.88	481801.44	4574618.55
	Gjatësia e murit mbajtës L=23.4m Lartësia e murit mbajtës = 4.8m			

Ndërhyrja ka një karakter linear dhe shtrihet në një rrip toke me sipërfaqe rreth 76m², në pronën nr. pasurie 289 në zonën kadastrale 3321.

3. KUADRI LIGJOR

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, akte ligjore, ndër më specifiket përmendim:

Tabela 2 Legjislacioni shqiptar për aplikimin e një VNM

Legjislacioni	Përmbledhje
Ligj Nr. 10431 (09.06.2011) ndryshuar nga ligji nr.31/2013, datë 14.02.2013; ligji nr.53/2020, datë 30.04.2020	"Për Mbrojtjen e Mjedisit" (i ndryshuar) - Ky ligj përcakton kuadrin ligjor të mbrojtjes së mjedisit, kornizën dhe kompetencat institucionale, parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe lejet mjedisore. Ligji bazohet në parimet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira të menaxhimit të mjedisit.
Ligj Nr. 10440 (07.07.2011) ndryshuar nga ligji nr.12/2015, datë 26.02.2015; ligji nr.128/2020, datë 22.10.2020	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (i ndryshuar) përcakton parimet e një VNM-je, përcakton kategoritë e projekteve me ndikim në mjedis dhe përcakton përgjegjësitë dhe të drejtat e institucioneve dhe publikut në procedurën e VNM-së. Ligji

Legjislacioni	Përmbledhje
	përcakton kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për sa i përket procedurës, shqyrtimit e raportit të VNM-së dhe miratimin përfundimtar të tij.
Ligji Nr. 10448 (14.07.2011) ndryshuar nga ligji nr.44/2013, datë 14.02.2013; ligji nr.60/2014, datë 19.06.2014; ligji nr.52/2020, datë 30.04.2020	"Për lejet mjedisore" (i ndryshuar) - përcakton kushtet dhe termat e dhënies së lejeve mjedisore për operatorët industrialë dhe përcakton masat për parandalimin dhe kontrollin e shkarkimit të ndotjeve dhe menaxhimin në mënyrë të sigurt të kimikateve. Në përgjithësi, objekti i kuadrit rregullator është: të parandalojë dëmtimin e mjedisit; të garantojë përputhjen me standardet e shëndetit; dhe mbrojtjen nga çdo detyrim i mbetur.
VKM Nr.686 (29.07.2015) ndryshuar nga VKM nr.95, datë 14.02.2018; VKM nr. 714, datë 06.11.2019 VKM nr. 828, datë 28.12.2023	"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" , të ndryshuar - Akti përcakton rregullat specifike dhe të hollësishme për procedurën, kuadrin dhe strukturën e raportit dhe shtojcave të VNM-së, afatin kohor të procedurës, kërkesën për aprovim, vendimin përfundimtar dhe monitorimin e ndikimit dhe raportimin gjatë ekzekutimit të projektit.
VKM Nr. 247 (30.04.2014), ndryshuar nga VKM nr. 268, datë 27.04.2023	"Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" - Akti përcakton kërkesat specifike për konsultimin me grupet e interesit, duke u fokusuar në konsultimet me komunitetet lokale. Gjithashtu, jep detaje mbi procedurën që duhet ndjekur, afatin kohor dhe botimin në media.

3.1 Procedura e miratimit mjedisor

Të gjitha projektet që lidhen me ndikimet e mundshme në mjedis, do të kryejnë një VNM para fillimit të zbatimit të projektit. Raporti i VNM-së dhe dokumentet e tjera të nevojshme do t'i paraqiten MTM e cila do t'i transferojë skedarët e projektit në AKM për rishikim. Projekti do

të miratohet me Vendim/ Deklaratë Mjedisore të AKM-së dhe MTM. Procedura e VNM-së përfshin afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit/ deklaratës mjedisore të ndryshuar.

Grafiku i procedurës VNM është ilustruar në figurën më poshtë dhe është bazuar në kërkesat ligjore të ligjit nr.10440 /2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, Neni 8, Pika b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;

Sipas Ligjit Nr.10440/2011 (neni 11), në përfundim të procesit të VNM-së, AKM-ja do të vendos nëse do të lëshohet një Deklaratë e Mjedisit ose nëse kërkohen studime të mëtejshme (d.m.th. VNM e thelluar). Është parashikuar që në fund të procesit të VNM, MTM të lëshojë Deklaratën e Mjedisit. Për këtë arsye do të bëhet një aplikim në MTM për një Deklaratë Mjedisore. Dokumentet që kërkohen të paraqiten në MTM së bashku me kërkesën për Deklaratën e Mjedisit përbëhen nga:

- Raporti i ndërveprimit mjedisor;
- Raport i plotë i VNM;
- Përmbledhje jo-teknike;
- Raporti teknik që përmbledh projektin;
- Një përmbledhje e procesit të konsultimit me publikun dhe palët e tjera të interesuara, të bëra gjatë procesit të VNM-së;
- Një kopje e pagesës së tarifës së shërbimit, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.

Institucionet kombëtare, rajonale dhe vendore me një rol gjatë procesit të VNM-së janë:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura;
- Bashkia Tiranë.

Përveç legjislacionit që lidhet posaçërisht me nevojën për një VNM, ekzistojnë politika, ligje dhe rregullore kombëtare të zbatueshme për projektin e propozuar dhe aspektet e tij mjedisore dhe sociale. Për më tepër, Shqipëria ka zhvilluar standarde mjedisore që bazohen kryesisht në direktivat e Komisionit Europian. Standardet ekzistuese përfshijnë: mbrojtjen e biodiversitetit;

trashëgiminë kulturore, emetimet në ajër; nivelet e zhurmës, cilësinë dhe shkarkimin e ujërave dhe menaxhimin e mbetjeve.




Figura 2 Procedura e VNM-së dhe afatet kohore sipas legjislacionit shqiptar

3.2 Kuadri i mbrojtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura

MTM është përgjegjëse për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore në Shqipëri, përfshirë mbrojtjen e mjedisit, pyjet, biodiversitetin, kullotat dhe rrjedhat ujore. Biodiversiteti në Shqipëri mbrohet me legjislacion të veçantë dhe me masa praktike, siç është parashikuar në sistemin e Zonave të Mbrojtura (ZM). Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit dhe rëndësia e projektit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3 Legjislacioni shqiptar mbi biodiversitetin

Legjislacioni	Përmbledhje
BIODIVERSITETI	
Ligji Nr. 9587 (20.07.2006) (përfshirë ndryshimin në ligjin Nr. 37/2013, datë 14.02.2013 Ligji nr.68/2014, datë 03.07.2014 dhe ligji no.41/2020, dated 23.04.2020)	“Ligji për mbrojtjen e Biodiversitetit” (i ndryshuar) - Ky ligj përcakton kërkesat për ruajtjen dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik, përfshij zonat e mbrojtura, habitatet dhe speciet e ndjeshme. Ligji kërkon një vlerësim biologjik si pjesë të vlerësimit mjedisor dhe mbledhjes së të gjitha të dhënave përkatëse për procesin e vendimmarrjes.
VKM nr.31, datë 20.01.2016	“Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit”- Kjo VKM synon të jetë një udhëzues për mënyrën se si vendi synon të përmbushë objektivat e Konventës së Diversitetit Biologjik në kuadër të detyrimeve kombëtare dhe planet e veprimit paraqesin hapat që duhet të merren për të arritur qëllimet e strategjisë.
Ligji nr. 81/2017, datë 04.07.2017, i ndryshuar	"Për Zonat e Mbrojtura" - Ky ligj rregullon të gjitha çështjet që lidhen me Zonat e Mbrojtura në Shqipëri. Ai përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri, rregullat e menaxhimit dhe rolet në procesin e vendimmarrjes. Kërkon pajtueshmëri me rregullat specifike gjatë hyrjes, punës dhe kryerjes së ndonjë aktiviteti tjetër në afërsi dhe/ ose brenda zonave të mbrojtura.

Legjislacioni	Përmbledhje
Urdhër nr. 1280, datë 20.11.2013	"Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër" (i ndryshuar) - Ky urdhër përcakton statusin e ruajtjes së llojeve të florës dhe faunës në Shqipëri.
ZONAT E MBROJTURA	
Ligji nr. 81/2017, datë 04.07.2017, i ndryshuar	"Për Zonat e Mbrojtura" - Ky ligj rregullon të gjitha çështjet që lidhen me Zonat e Mbrojtura në Shqipëri. Ai përcakton kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri, rregullat e menaxhimit dhe rolet në procesin e vendimmarrjes. Kërkon pajtueshmëri me rregullat specifike gjatë hyrjes, punës dhe kryerjes së ndonjë aktiviteti tjetër në afërsi dhe/ ose brenda zonave të mbrojtura.
Urdhër nr. 1280, datë 20.11.2013	"Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër" (i ndryshuar) - Ky urdhër përcakton statusin e ruajtjes së llojeve të florës dhe faunës në Shqipëri.

Ligji Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" përcakton kategoritë e ndryshme të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri dhe mënyrën e menaxhimit të tyre. Ligji shqiptar nr. 81/2017 për zonat e mbrojtura (ZM) përcakton 7 kategori zonash të mbrojtura, secila me shkallë të ndryshme mbrojtjeje, që janë gjetur të jenë të pranishme në fushën e studimit:

- Rezervë strikte natyrore/ rezervat shkencor (Kategoria I);
- Park Kombëtar (Kategoria II);
- Monument Natyror (Kategoria III);
- Park Natyror Bashkiak (Kategoria IV);
- Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (Kategoria VI);
- Zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar (nuk ka kategori specifike mbrojtjeje).

3.3 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe rëndësia e projektit janë theksuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4 Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Legjislacioni	Përmbledhje
TRASHËGIMIA KULTURORE	
Ligji nr. 27/2018, datë 17.05.2018	"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" - Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Shqipëri rregullohen nga ky ligj". Ligji përcakton procedurat e ruajtjes dhe gjetjeve të rastësishme (objektet arkeologjike ose sendet me vlerë për trashëgiminë kulturore të cilat janë zbuluar rastësisht) që do të përdoren gjatë zbatimit të Projektit.
Neni 146 i ligjit nr.27/2018	Kërkon dhe detyron këdo që zbulon ose gërmon rastësisht objekte me vlerë për trashëgiminë kulturore gjatë punimeve të ndërtimit, të pezullojë menjëherë punën dhe të informojë autoritetet përkatëse lokale brenda tri ditëve. Autoritetet lokale përkatëse përbëhen nga zyra e qeverisjes vendore (Bashkia), Komisariati i Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (RDCH - DRTK) DRTK-ja verifikon situatën/ gjetjet dhe raporton në Institutin e Monumenteve të Kulturës (KPM - IMK). Këto institucione janë përgjegjëse për vlerësimin e vlerës arkeologjike të objekteve të gjetura dhe përcaktimin nëse puna mund të vazhdojë ose nëse duhet pezulluar derisa të ndërmerren studime të mëtejshme.
Neni 5/64 dhe neni 31 i ligjit nr.27/2018	Përcakton ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo materiale nëpërmjet masave që synojnë ruajtjen afatgjatë të pasurive të tilla kulturore.

3.4. Mbrojtja e strukturës fizike

Shqipëria ka zhvilluar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit fizik, ku përfshihen udhëzimet, pragu dhe kufiri i emetimit. Legjislacioni në lidhje me shkarkimin e ujrave, emetimin e ajrit, zhurmës, emetimin nga automjetet dhe pajisjet, cilësinë e karburantit, mbetjet dhe ujërat e zeza është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5 Legjislacioni në lidhje me mbrojtjen e mjedisit fizik

Legjislacioni	Përmbledhje
UJI	
Ligji Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 ndryshuar nga ligji nr. 6/2018, datë 08.02.2018	“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” bazuar në direktivën 2000/60/KE mbi kuadrin ujor. Qëllimi i ligjit përqendrohet në: (i) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; (ii) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; Ky ligj parashikon përkufizimin e trupave ujorë dhe vendos disa masa mbrojtëse dhe kufizime përdorimi dhe kërkon që të miratohen të tjera nga aktet nënligjore. Ligji përcakton brigjet e burimeve ujore, kufizimin e veprimtarive të caktuara të dëmshme ndërtimore në brigje ^{1/} dhe zonat ujore të mbrojtura.
VKM Nr. 177 (31.03.2005)	“Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse” jep normat e lejuara për shkarkimin e lumenjve në mjedis, për burimet ujore të mbrojtura.
VKM Nr. 379 (25.05.2016)	"Për miratimin e rregullores ² për Cilësinë e Ujit të Pijshëm"- Qëllimi i kësaj rregulloreje është të mbrojë shëndetin e njeriut nga efektet e dëmshme të çdo ndotje të ujit të destinuar për konsum njerëzor, duke siguruar që ai është i shëndetshëm dhe i pastër. Rregullon disa çështje lidhur me, testimin e ujërave të pijshëm dhe zonat e mbrojtjes rreth puseve të ujit

1 "Brigjet" janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrënjeve. që, në funksion të përdorimit, përfshijnë të paktën dy zona: i me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje, një herë në 25 vjet, të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta, ii. me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal të plotave me probabilitet përsëritjeje një herë në 25 vjet të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore.

2 Bazuar në Direktivën e Këshillit të KE-së 98/83 / EC të datës 3 nëntor 1998 mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor) ka të bëjë me cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Legjislacioni	Përmbledhje
	ose depozitimit të ujërave nëntokësore të komunitetit. Rregullorja përcakton tri zona të mbrojtura (zona tampon) nga pusët e ujërave nëntokësore ose vendet e depozitimit të ujit në tokë. Zona e menjëhershme e mbrojtjes varion nga 15 deri në 100 m nga boshti i pusit ose depozita. Distanca e saktë përcaktohet në bazë të vlerësimit të formacioneve gjeologjike nga ekspertit hidro-gjeologjik. Zona e dytë dhe e tretë tampon janë përreth të parës, por për ato zona rregullorja nuk i përcakton kriteret e distancës, por kufizon aktivitetet që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit, siç janë, asgjësimi ose groposja e mbeturinave, hapjen e gropave, etj.
NDRYSHIMET KLIMATIKE	
Ligji Nr. 155/2020, datë 17.12.2020	“Për ndryshimet klimatike”. Ky ligj përputhet pjesërisht me: - Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, date 13 Tetor, 2003 " Për krijimin e një skeme ose tregtimin e lejeve për emetimet e gazeve serrë brenda Komunitetit dhe ndryshimin e Direktivës së Këshillit 96/61/EC", i ndryshuar". Numri CELEX 32003L0887, Gazeta Zyrtare e bashkimit Evropian, seria L, nr. 275, datë 25.10.2003, fq. 32-46. - Rregullorja (BE) nr. 525/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 Maj, 2013 " Për mekanizmin e monitorimit dhe raportimit të emetimeve të gazeve serrë dhe raportimin e informacioneve të tjera lidhur me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, që shfuqizon vendimin nr.280/2004/KE", i ndryshuar, Numri CELEX 32013R0525, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.06.2013, fq. 13 - 40.
VKM Nr. 466, datë 03.07.2019	Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SKNK) dhe dy anekset e saj, Plani Kombëtar i Veprimit për Zbutjen (PKVZ) dhe Plani Kombëtar

Legjislacioni	Përmbledhje
	i Përshtatjes (PKP) është dokumenti kryesor strategjik që trajton ndryshimet klimatike në Shqipëri. Strategjia është miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në vitin 2019 dhe është hartuar në mbështetje të legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën dhe synon të forcojë koordinimin ndërmjet sektorëve në lidhje me masat e përshtatjes, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
AJRI	
Ligji Nr. 162 (04.12.2014), ndryshuar nga ligji nr.52/2020, datë 30.04.2020	“Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” transponon plotësisht Direktivën 2008/50 / KE mbi cilësinë e ajrit në mjedis dhe për ajër më të pastër për Evropën, si dhe Direktivën 2004/107 / KE në lidhje me arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike poli ciklike në ajrin në mjedis. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018 dhe siguron kuadrin institucional, rregulloret, rolet, gjobat për garantimin e pajtueshmërisë. Ligji përcakton që personat fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, kanë për detyrë të mbajnë ajrin e pastër dhe ta mbrojnë atë nga ndotja e shkaktuar nga aktivitetet që ata kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
VKM nr.594, datë 10.09.2014	“Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të ambientit” me synim përmirësimin e cilësisë së ajrit për një periudhë të gjatë përmes përcaktimit të objektivave. Përmirësimi i cilësisë së ajrit ndikon drejtpërdrejt në shëndetin publik, cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit.
VKM nr.412, datë 19.06.2019	“Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
EMETIMI NGA AUTOMJETET	
Udhëzimi Nr. 6527 (24.12.2004)	Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe



Legjislacioni	Përmbledhje
	mënyrat e kontrollit të tyre” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 12, datë 15.06.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6527, të datës 24.12.2004 shoqëruar me Manualin e Kontrollit të Automjeteve.
EMETIMET NGA TRANSPORTI, AUTOMJETET DHE PAJISJET	
Udhëzimi Nr.6527 (24.12.2004)	“Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre” të ndryshuar - Ky udhëzim përfshin kërkesat për inspektimet vjetore të automjeteve dhe shkarkimet e lejuara të ajrit. Të gjitha automjetet duhet të jenë në përputhje me këto norma.
Urdhri i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 149 (07.04.2014)	“Për miratimin e rregullores për zbatimin e vlefshmërisë ajrore dhe certifikimit mjedisor të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që kanë lidhje me to, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe të prodhimit”, plotësisht të përafëruara me Rregulloren e BE-së Nr. 748/2012 të datës 03.08.2012, që përcakton rregullat zbatuese për certifikimin e vlefshmërisë ajrore dhe mjedisore të avionëve dhe të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve përkatëse, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit.
VKM Nr.613 (07.09.2011)	"Miratimi i rregullave teknike për vlerësimin e konformitetit të zhurmës në mjedis për pajisjet e instaluar në hapësira të hapura". Përcakton normat e emetimit të zhurmës për pajisje të caktuara që gjenerojnë zhurmë, të tilla si; gjeneratorë elektrikë, traktorë, kompresorë etj. Rregullorja përcakton pragun e përcaktuar.
VKM Nr.10 (30.05.2011)	"Lidhur me miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiove dhe rimorkiatorëve të

Legjislacioni	Përmbledhje
	tyre të ndërkëmbyeshëm, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e tyre të ndara teknike" bazuar në Direktivën e BE-së 2003/37/EC të datës 26.05.2003.
ZHURMA	
Ligj Nr. 9774, datë 12.07.2007, i ndryshuar nga ligji Nr. 39/2013, datë 14.02.2013 dhe ligji nr.50/2023, datë 22.06.2023	"Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" - përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, si të shmangim dhe të parandalojmë, zvogëlojmë dhe eliminojmë efektet e dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshij dhe shqetësimet nga zhurma. Ky ligj ka për qëllim të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të shkaktuara nga emetimet e zhurmave dhe përcakton rregullat, autoritetet, inspektimet, etj.
VKM Nr. 587, datë 07.07.2010	"Për monitorimin dhe kontrollin e niveleve të zhurmës në zonat urbane dhe turistike" - përcakton rregullat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zhurma dhe administrimin e nivelit të zhurmës në zonat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 1063 (23.12.2015)	"Për miratimin e rregullave teknike "mbi emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura" përcakton normat e emetimit të zhurmës për zhurmë të gjeneruar nga pajisjeve të caktuara siç janë gjeneratorët e energjisë elektrike, traktorët, kompresorët etj. Rregullorja jep kufijtë e përcaktuar (kryesisht kapacitetin e energjisë - kË).
Udhëzim Nr. 6527/2004	Udhëzimi rregullon nivelet e prodhimit të zhurmës nga automjetet dhe metodat e kontrollit. Kjo përfshin kërkesat për inspektime vjetore të automjeteve dhe përmbushjen e normave të paracaktuara. Pajtueshmëria e këtyre normave do të verifikohet me certifikatën e kontrollit të lëshuar nga SGS Albania ³ .

³ <https://www.automotivealbania.sgs.com/index.php>



Legjislacioni	Përmbledhje
Udhëzim i përbashkët nr.2 (15.11.2023)	Ministria përgjegjëse për mjedisin, Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Ministria përgjegjëse për punët e brendshme kanë propozuar dhe miratuar udhëzimin e përbashkët “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”.
VKM nr.123, datë 17.02.2011	“Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e zhurmave” është një nga dokumentet më të rëndësishme që ndihmon në hartimin e planit vendor për menaxhimin e zhurmave.
CILËSIA E KARBURANTIT	
VKM Nr. 147 (21.03.2007)	“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”.
VKM Nr.781 (14.11.2012)	“Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor).”
MBETJET	
Ligji Nr.10463 (22.09.2011) i ndryshuar nga ligji nr.32/2013, datë 14.02.2013; ligji nr.156/2013, datë 10.10.2013 dhe ligji nr.28/2022, datë 17.03.2022	“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (të ndryshuar) - synon të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe të sigurojë menaxhim të shëndetshëm mjedisor të mbetjeve nëpërmjet një menaxhimi të integruar.
VKM nr.402, datë 30.06.2021	“Për miratimin e katalogut të mbetjeve” - i cili bën klasifikimin e mbetjeve, bazuar në llojet e industrisë, dhe kriteret për të vlerësuar rrezikshmërinë e mbetjeve. Rregullorja kodifikon llojet e mbetjeve bazuar në Katalogun Evropian të Mbetjeve.
VKM Nr. 229 (23.04.2014) i ndryshuar nga VKM nr.1031, datë 16.12.2020	“Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”- Rregullorja e re e zbatuar kërkon transferimin e

Legjislacioni	Përmbledhje
	mbetjeve nga kompanitë e licensuara, duke siguruar asgjësimin përfundimtar në impiante të miratuara. Ky vendim kërkon dokumentimin e transferimit të mbetjeve dhe dorëzimin e certifikatës përfundimtare të asgjësimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Rregullorja kërkon që të gjitha kompanitë gjeneruese të mbetjeve të regjistrohen në AKM dhe të kenë një numër personal të gjenerimit të mbetjeve.
VKM Nr. 371 (11.06.2014) i ndryshuar nga VKM nr.1032, datë 16.12.2020	“Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të domkumentit të dorëzimit të tyre” – Rregullorja e re në fuqi kërkon transferimin e mbetjeve nga kompani të licensuara dhe sigurimin e depozitimit përfundimtar në impiante të miratuara. Ky vendim kërkon dokumentimin e transferimit të mbetjeve dhe dorëzimin e certifikatës përfundimtare të asgjësimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Rregullorja kërkon që të gjitha kompanitë gjeneruese të mbetjeve të regjistrohen në AKM dhe të kenë një numër personal të gjenerimit të mbetjeve.
VKM Nr. 418 (25.06.2014)	Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”. Objekti i këtij vendimi është realizimi i një grumbullimi të diferencuar për këto mbetje: letër, metal, plastikë, qelq
VKM Nr. 575 (24.06.2015)	“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Objekti i këtij vendimi është menaxhimi i mbetjeve inerte që gjenerohen nga kompanitë që operojnë në zonën e ndërtimit.
UJËRAT E ZEZA	
Ligji Nr. 9115/2003 (24.07.2003), i ndryshuar nga ligji nr.34/2013, datë 14.02.2013	“Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” jep rregulloret që tregojnë nevojën për trajtimin e ujit të ndotur para se të shkarkohet. Neni 6 përcakton detyrimin e personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve



Legjislacioni	Përmbledhje
	shkarkon ujëra të ndotura, janë të detyruara të marrin masa për të: a) zvogëluar vazhdimisht sasinë e ujërave të përdorura që shkarkohen në mjedisin pritës; b) zvogëluar shkallën e ndotjes në ujërat e shkarkuara, veçanërisht ndotjen e shkaktuar nga substancat e rrezikshme dhe mbeturinat; c) menaxhuar dhe trajtuar ujërat e ndotura. Për të përmbushur këto detyrime, personat fizikë dhe juridikë, aktivitetet e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura, duhet të hartojnë një program masash teknike, teknologjike dhe organizative. Ky program është subjekt kontrolli nga Inspektorati i Mjedisit, autoriteti i licencimit dhe strukturat e qeverisjes vendore.

3.5 Shëndeti dhe siguria

Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" garanton sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidente, informimit, këshillimit, pjesëmarrje të balancuar në përputhje me ligjin. Ky ligj është në zbatim të kuadrit ligjor të mëposhtëm:

- Direktivës së Këshillit Europian 89/391/EEC, datë 12 korrik 1989 "Për vendosjen e masave për nxitjen e përmirësimit në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë";
- Direktivës së Këshillit Evropian 94/33 EEC, datë 22 korrik 1994 "Për mbrojtjen e të rinjve në punë", neni 6;
- Direktivës së Këshillit Evropian 92/85 EEC "Për vendosjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjëseve që janë shtatzëna dhe të atyre që kanë lindur së fundmi ose që ushqejnë fëmijën me gjë".

Legjislacioni shqiptar për shëndetin dhe sigurinë dhe rëndësia e tyre për projektin janë theksuar në Tabelën e mëposhtme.

Tabela 6 Legjislacioni për shëndetin dhe sigurinë

Legjislacioni	Përmbledhje
SHËNDETI DHE SIGURIA	

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË

Legjislacioni	Përmbledhje
Ligji nr. 10237 (18.02.2010)	"Për sigurinë dhe shëndetin në punë" - Ky ligj rregullon kuadrin ligjor për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe përcakton rolet e secilës palë që i nënshtrohet ligjit.
Ligji nr.7643, (02.12.1992), i ndryshuar nga ligji nr.7941, datë 31.05.1995, ligji nr.9635, datë 06.11.2006, ligji nr.45/2013, datë 14.02.2013, ligji nr.54/2020, datë 30.04.2020	Inspektorati Sanitar Shtetëror synon të mbrojë punëtorët nga ndikimet e kushteve të pafavorshme të punës, si ekspozimi ndaj substancave toksike, rrezatimi, zhurma e papërshtatshme, vibrimet, mikroklima e pafavorshme, si dhe kontrolli i nivelit të sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve si rezultat i kushteve të pafavorshme.
Ligji Nr. 9863/2008 (28.01.2008) i ndryshuar nga ligji nr.10137, datë 11.05.2009; ligji nr.74/2013, datë 14.02.2013; ligji nr.8/2019, datë 26.02.2019; ligji nr.16/2020, datë 12.02.2020; ligji nr.10/2022, datë 27.01.2022	"Për ushqimin" përcakton rregullat e sigurisë ushqimore në Shqipëri.
Ligji nr. 10433/2011 (16.06.2011)	"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit.
VKM Nr. 562/2013 (03.07.2013)	Vendimi i Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
VKM Nr. 312/2010 (05.05.2010)	"Për sigurinë në kantier" përcakton rregullat e sigurisë për aktivitetet e ndërtimit.
VKM Nr. 410/2015 (13.05.2015)	"Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial". Ky akt rregullon inspektimin e instalimeve që lidhen me proceset industriale në Shqipëri
Vendimi Nr. 692/2001 (13.12.2001)	"Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë".
VKM Nr. 842/2014 (03.12.2014)	"Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga rreziqet e lidhura me zhurmën në

Legjislacioni	Përmbledhje
	vendin e punës” kërkon që punëdhënësi të vlerësojë nivelin e zhurmës në vendin e punës dhe të sigurojë mbrojtjen e punëtorëve të tij.
VKM Nr. 841 (03.12.2014)	Për mbrojtjen e punonjësve nga rreziku që lidhet me mekanikën e dridhjeve në vendin e punës

3.6 Ligje të tjera kombëtare lidhur me planifikimin e territorit dhe përdorimin e tokës

Ligjet shqiptare të tjera që kanë të bëjnë me planifikimin e territorit dhe përdorimin e tokës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7 Ligje të tjera kombëtare që kanë lidhje me planifikimin e territorit dhe përdorimin e tokës

Legjislacioni	Përmbledhje
PËRDORIMI I TOKËS DHE PLANIFIKIMI I TERRITORIT	
Ligji Nr. 107/2014, (31.07.2014), i ndryshuar nga ligji nr.73/2015, datë 09.07.2015; ligji nr.28/2017, datë 23.03.2017; ligji nr.42/2019, datë 04.07.2019; ligji nr.119/2020, datë 07.10.2020	"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" - Ligji ka për qëllim integrimin e kuadrit ligjor të planifikimit urban në një ligj të vetëm dhe, përfshin konceptin e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe të shëndetit dhe sigurisë së komunitetit, për planifikimin e territorit.
VKM Nr. 408 (13.5.2015) i ndryshuar nga VKM nr.672, datë 29.07.2015; VKM nr.1043, datë 16.12.2015; VKM nr.271, datë 06.04.2016; VKM nr.231, datë 21.03.2017; VKM nr.355, datë 19.04.2018; VKM nr.693, datë 02.10.2019; VKM nr.796, datë 11.12.2019; VKM nr.457, datë 29.06.2022)	"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit". Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zbatimin e instrumenteve të zhvillimit, si dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të zhvillimit të kontrollit.
Ligji Nr. 9244 (17.06.2004), i ndryshuar nga ligji nr.69/2013, datë 14.02.2013; ligji nr.131/2014, datë 02.10.2014; ligji nr.68/2013, datë 21.07.2023	"Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" përcakton statusin e mbrojtjes të fushave bujqësore të dhëna.

Legjislacioni	Përmbledhje
Ligji Nr. 8752/2001 (26.03.2001 i ndryshuar nga ligji nr.9244, datë 17.06.2004; ligji nr.10257, datë 25.03.2010; ligji nr.16/2012, datë 16.02.2012; ligji nr.130/2014, datë 02.10.2014.	"Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar nga ligji Nr. 10257/2010 regullon çështjet e përdorimit të tokës dhe përputhshmërinë e tyre me Planifikimin Rajonal.

3.7 Kuadri ligjor evropian

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përjasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore janë:

- ♣ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ♣ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- ♣ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ♣ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) ” Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- ♣ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ♣ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- ♣ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- ♣ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- ♣ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ♣ Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ♣ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.

♣ Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEE/CE 78/659 për cilësinë e ujërave të ëmbla.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së. Gjatë dy dekadave të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore si dhe përditësimin e tyre sipas kërkesave evropiane. Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë periudhës 2010-2023.

4. PËRSHKRIMI I MJEDISIT

4.1 Përshkrimi i mbulesës bimore

Zona përreth ku do të kryhen ndërhyrjet për rindërtimin e murit mbajtës, është zonë me bimësi barishtore si dhe pemë si lisi e dushku që nuk janë bimësi të rrezikuara në zhdukje që të monitorohen nga institucionet e mbrojtjes së mjedisit. Ndërsa, në brendësi të pronës ku do të ndërtohet muri mbajtës ka pemë frutore. Megjithatë, do të ketë një kujdes të veçantë gjatë punimeve për të mos prekur asnjë prej pemëve as brenda territorit të murit rrethues dhe as përreth saj. Nuk do të ndërhyet në mjedis por vetëm në zonën ku është prezent muri egzistues i cili ka rënë si rrjedhojë e rreshqitjes së tokës.



REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN “HAMDI CENOJMERI”, TIRANË

LD



Figura 3 Pamje të gjendjes egzistuese

4.2 Burimet ujore në zonën e Tiranës

Si vend i Shqipërisë së Mesme, zona e Tiranës përbëhet nga lumi i Lanës i cili është një lum që formohet nga bashkimi i disa lumenjve dhe përrenjve të zonës dhe në veri të territorit nga disa përrenj e lumenj të tjerë lokal. Asnjë prej lumenjve që përshkojnë territorin e Tiranës si: Lumi i Lanës, Lumi i Tiranës dhe Lumi Erzen, nuk kalojnë afër sipërfaqes së projektit të propozuar. Lumenjtë kalojnë prane fshatrave të zonës përreth dhe derdhen në detin Adriatik.

4.2.1 Burimet ujore sipërfaqësore

Referuar dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Ujit, Tirana përfshihet në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen dhe Ishëm, i cili formon një basen të vetëm ujqor nga gjashtë në total që ka vendi. Ishmi formohet nga bashkimi i ujërave të lumit të Tiranës, lumit të Tërkuzës dhe lumit të Zezës, ndër të cilët si degë kryesore konsiderohet lumi i Tiranës. Pellgu i tij ujëmbledhës pozicionohet në Shqipërinë e Mesme ndërmjet pellgut të Matit në veri dhe pellgut të lumit Erzen në jug, vija ujëndarëse me të cilin kalon nëpër malet Micaku i Shën Mërisë (1828 m) dhe atë të Dajtit (1612 m). Ai ka një sipërfaqe prej 673 km² me lartësi mesatare 357 m mbi nivelin e detit, ndërsa gjatësia e shtratit është 79.2 km. Në përgjithësi, të tre degët kryesore të tij dhe që rrjedhin në territorin e bashkisë Tiranë, ruajnë karakteristikat e

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË

LS

përrenjve malor me rrjedhje të rrëmbyeshme gjate pilotave dhe me kohëardhje të vogël. Lumi i Tiranës ka një gjatësi rreth 35 km dhe në pjesën e sipërme të tij formohet nga tre degë: Përroi i Mojsitit, Selitës dhe Zall-Bastarit. Në largësi 2.5 km nga qendra e komunës Zall-Dajt ai ndërron emrin dhe quhet lumi i Tiranës dhe vazhdon me këtë emërtim deri në afërsi të fshatit Larushk, ku bashkohet me lumin e Lanës, i cili përshkon Tiranën nga verilindja në jugperëndim, ka një gjatësi prej 29 km, sipërfaqe ujëmbledhëse 67 m^2 , lartësi mesatare 179 m mbi nivelin e detit dhe rënie 24 m/km; dhe ai i Limuthit, i cili ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 31 km^2 . Lumi i Tiranës furnizohet me ujin e Selitës dhe të disa përrenjve më të vegjël me karakter stinor, që derdhen në shtratin e tij. Lumi i Tërkuzës rrjedh në veriperëndim të Tiranës dhe në afërsi të Fushë Prezës bashkohet me lumin e Tiranës. Ai buron në pjesën veriperëndimore të Malit me Gropa dhe ka një gjatësi rreth 44.1 km. Pellgu i tij ujëmbledhës ka një sipërfaqe 182 km^2 , lartësi mesatare 458 m mbi nivelin e detit dhe rënie 22 m/km. Përpara ndërtimit të rezervuarit të Bovillës, shtimi i rrjedhës së lumit gjatë stinës së dimrit dhe pranverës shkaktonte përmytje të shumta. Me ngritjen e rezervuarit të Bovillës dhe disiplinimin e shtratin me prita e argjinatura, ujërat e lumit të Tërkuzës janë shfrytëzuar dhe shfrytëzohen për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës. Lumi i Zezës ka një gjatësi të përgjithshme prej 29 km. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 71.3 km^2 , ndërsa lartësia mesatare 487 m mbi nivelin e detit. Lumi i Zezës dallohet për regjim torrencial (të rrëmbyer) dhe e siguron 68% të ujit nga reshjet që bien në pellgun ujëmbledhës të tij. Prurja mesatare shumëvjeçare e tij është $Q_0 = 2.15 \text{ m}^3/\text{s}$, ndërsa koeficienti i rrjedhës është 0.68 dhe për këtë arsye, në rast të prurjeve të mëdha, lumi i Zezës shkakton përmytje në zonat e ndodhura pranë brigjeve të tij. Ndërtimi litologjik i pellgut ujëmbledhës të Ishmit favorizon krijimin e një rrjedhe të fuqishme nëntokësore, e cila përfaqëson 40% të rrjedhës së tij vjetore. Ujërat e lumit Ishëm përdoren kryesisht për ujitje. Lumi Erzen përfaqëson një ndër lumenjtë e rëndësishëm që përshkojnë pjesën qendrore të vendit. Pellgu i lumit Erzen me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 760 km^2 , zhvillohet në zonën malore në lindje dhe juglindje të Tiranës dhe ka një lartësi mesatare 435 m mbi nivelin e detit. Erzeni buron në afërsi të Qafës së Gurakuqit, në kuotën 1300 m mbi nivelin e detit dhe ka një gjatësi të përgjithshme 109 km dhe prurje mesatare vjetore 18.1 m/s me një modul të prurjes prej 24 l/s/km^2 . Koeficienti i rrjedhjes ujore vjetore për të gjithë pellgun e Erzenit është $a=0.51$. Si pasojë e ndërtimit gjeologjik të pellgut të tij ujëmbledhës, formacione të papërshkueshme në 60% të sipërfaqes, gjysëm të përshkueshme, ushqimi nëntokësor përfaqëson 31% të rrjedhës vjetore, ndërsa ai sipërfaqësor 69% të saj. Ujërat e lumit Erzen janë përdorur dhe përdoren kryesisht për vaditje dhe shumë pak për ujë të pijshëm (pas depurifikimit). Përgjatë luginës së tij ka shumë puse të cekët uji që përdoren për furnizimin me ujë në zonat rurale. Figura në vijim tregon hartën e burimeve ujore në bashkinë Tiranë.

4.2.2 Ujërat nëntokësorë

Në pikëpamje hidrogeologjike, territori i Bashkisë Tiranë shtrihet mbi akuiferin e zhavorreve të Kuaternarit të Tiranës, i cili përfaqëson zonën e ushqimit të pellgut të madh ujëmbajtës të Tiranë – Ishmit. Në këtë pellg, horizonti kryesor ujëmbajtës përfaqësohet nga depozitimet e zhavorreve me përhapje në të gjithë zonën ku shtrihet qyteti i Tiranës, Kombinati, Yzberishi, Mëzezi, Laknasi, Valiasi etj. Trashësia e depozitimeve rritet nga qyteti në drejtim të Selitës së Vogël, Kombinat, Mëzez-Laknas. Trashësia e shtresës ujëmbajtëse varion nga 2-3 m, në 5-10 m, trashësi më të madhe ka në sektorët Selitë e Vogël, Unaza e Re, Kombinat, Mëzez-Laknas. Shtresa ujëmbajtëse ka tregues të mirë hidraulik, prurja specifike varion nga 2-5 l/sek/m deri në 10-20 l/sek/m, koeficienti i filtrimit varion nga 50-100 m/ditë në 200-400 m/ditë. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferiteve të kuaternarit varion $K = 0.85 - 0.95$, ndërsa sasia e ujit që shfrytëzohet është $Q = 1200 - 1300$ l/sek dhe përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës, Kamzës dhe qendra të tjera të banuara dhe si ujë teknologjik. Për sa i përket karakterit të ujërave nëntokësore të këtij pellgu, takohen kryesisht ujëra pa presion (qyteti i Tiranës, Laprakë etj.) dhe me presion, por pa vetërrjedhje (Kombinat, Selitë, Laknas etj.) dhe me presion, por pa vetërrjedhje (Kombinat, Selitë, Laknas).

Ujërat nëntokësorë të pellgut Tiranë ushqehen nga infiltrimet e reshjeve atmosferike, në veçanti kur ato janë pa presion, si dhe nga infiltrimet e ujërave sipërfaqësore të lumenjve Tiranë, Tërkuzë. Vetitë fiziko-kimike të ujërave janë të mira me $M_p = 0.5 - 0.8$ mg/l. Nga analizat e kryera rezulton se janë neutral, jo agresive ndaj hekurit dhe betonit.




Figura 4 Harta e sistemit ujq

4.2.3 Rezervuarët

Ujërat sipërfaqësore të Tiranës përfshijnë edhe një numër të konsiderueshëm rezervuarësh dhe ujëmbledhësish.

- Liqeni artificial i Tiranës, ndërtuar në parkun më të madh të qytetit, me thellësi prej 12.5m, sipërfaqe 0.40 km² dhe lartësi 116.9 m mbi nivelin e detit. Liqeni artificial ushqehet kryesisht nga pellgu i tij shimbledhës dhe ka një kapacitet prej 2 500.000 m³ ujë. I ndërtuar fillimisht për furnizim me ujë nga liqeni i Farkës, ai filloi të përdorej për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në kodrat e Selitës dhe Yzberishit. Aktualisht pellgu shimbledhës nuk e siguron mbushjen me ujë në nivelin maksimal për gjithë vitin hidrologjik. Përveç kësaj traseja e shkarkuesit egzistues nuk është në gjendje pune.

- Rezervuari i Paskuqanit, ndërtuar në vitin 1983 me dy diga, Paskuqan 1 dhe 2. Volumi i ujit që mbledh rezervuari është 9 Mm³. Sipërfaqja e ujitur nga ky rezervuar në fillimet e tij ka qenë 2500 ha por në ditët e sotme kjo sipërfaqe është afërsisht 150 ha.

- Rezervuari i Purezit, ndërtuar në vitin 1971 me volum uji 1.5 Mm³. Sipërfaqja e tokave të ujitura prej tij ka qenë afërsisht 500 ha, ndërsa në ditët e sotme është më e vogël, por nuk është vlerësuar akoma saktësisht.

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË

Handwritten signature

- Rezervuari i Kasharit, ndërtuar në vitin 1963 me volum uji 1.8 Mm³. Sipërfaqja e tokave të ujitura prej tij fillimisht ka qenë afërsisht 1600 ha, ndërsa aktualisht është rreth 300 ha.
- Rezervuari i Farkës, ndërtuar në vitin 1984 në volum uji 9.0 Mm³. Sipërfaqja fillestare e tokave të ujitura prej tij ka qenë afërsisht 1900 ha. Aktualisht është më e vogël, por nuk ka të dhëna për madhësinë.




Figura 5 Harta hidrogeologjike e qarkut Tiranë

4.3 Mjedisi fizik

4.3.1 Gjeologjia, geomorfologjia

Shqipëria si formacion gjeologjik është pjesë përbërëse e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjesë e degëzimit Dinaro-Albano-Helenid, ku ne bëjmë pjesë tek Albanidet. Qyteti i Tiranës zë vend në një rrafshinë midis Lumit Lana dhe Lumit Tirana. Kjo rrafshinë bën pjesë në një rrafshinë më të madhe ku ndodhen Kruja dhe Lezha, ujërat e të cilave rrjedhin drejt veriperëndimit. Mbi rrafshinë ngrihet 1600 metra Mali i Dajtit, i cili dominon horizontin në perëndim të qytetit. Kodrat më të ulëta të Saukut, Kërrabës dhe Vaqarit, që ngrihen 300 metra, rrethojnë luginën, përkatësisht në perëndim, lindje dhe jug. Kodrat më të ulëta formojnë vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave ajrore detare deri në Tiranë. Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet

të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbajtjeje për qytetin. Zhvillimi gjeologjik i territorit të Tiranës i përket Pliocenit dhe Kuaternarit kur ultësira praneadriatike nisi të dalë mbi ujë si pjesë e kontinentit. Deti u tërhoq përfundimisht. Gjatë kësaj periudhe në Kuaternar kanë ndodhur shumë procese që kanë çuar në formimin e strukturave antiklinale dhe sinklinale. Territori i Tiranës përbëhet gjithashtu nga depozitime terrigjene (ranore, konglomerate, argjile, gëlqeroresh etj. Në territorin e Tiranës ka dhe prurje aluvionale. Në ndërtimin e relievit të Tiranës kane ndikuar edhe tërmetet. Pasojë e këtij ndërtimi gjeologjik janë edhe pasuritë nëntokësore si qymyrguri etj. Zona përreth Tiranës bën pjesë në zonën tektonike Pran-Adriatike ku strukturat e ngritura antiklinale në lindje të këtij sheshi ndërtohen nga formacione Mollasike të Neogjenit.

4.3.2 Sizmiciteti

Trualli Shqiptar vendoset gjatë kufirit të përplasjes së dy pllakave të mëdha që lëvizin njëra kundër tjetrës; pllakës Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe është vatër e përqëndruar tërmetesh e cila preket më shpesh nga tërmete dëmtues. Tirana është zonë e prekur nga tërmetet ku nga pikëpamja sizmoteknike zona mund të goditet nga tërmete me magnitudë $M_{max}=5.5-6.0$ gradë Richter me intensitet 7 deri në 8 ballë e cila shkakton çarje në mur dhe rrëzim të copave të suvave. Por mundësitë për të goditur tërmetet me shumë ballë janë të vogla rreth 20%.

4.3.3 Klima

Klima e rajonit është mesdhetare fushore qendrore me karakteristikat klimaterike të rajonit të Shqipërisë Perëndimore. Në formimin e klimës ndikojnë një sërë faktorësh siç janë faktorët planetare (kozmiqe) dhe ato lokale. Tirana ka një klimë mesdhetare. Faktorët lokalë janë të lidhur me relievin. Faktori më aktiv në klimën e Tiranës është ndikimi i detit nëpërmjet të cilit bëhet i mundur qarkullimi i masave ajrore të Atlantikut dhe të Mesdheut. Në faktorët lokalë bën pjesë edhe veprimtaria e njeriut, që në Tiranë është shprehur me ndërhyrjet në kushtet natyrore.

- Temperatura mesatare vjetore 15.5°C
- Temperatura mesatare e Janarit 7°C
- Temperatura mesatare e Gushtit 24°C
- Temperatura absolute më e ulët ka zbritur në -9°C
- Temperatura absolute më e lartë ka arritur $39^{\circ}\text{C}-43^{\circ}\text{C}$
- Sasia mesatare vjetore e reshjeve 963 mm
- Sasia maksimale vjetore 1542 mm

- Sasia minimale vjetore 637.7 mm
- Orë me diell në vit 2786 orë
- Lagështia mesatare vjetore 70%
- Shpejtësia e erës më e madhe sipas muajve 24-40m/sek
- Drejtimi kryesor i erës veri-juglindore, perëndimore, puhi detare.
- Lartësia mbi nivelin e detit 89m.

Janë një element me rëndësi të madhe gjeografike dhe agrometeorologjike për ultësirën perëndimore. Erërat karakteristike për Tiranën janë brizat dhe puhitë. Gjatë verës në Tiranë ka rreth 71 ditë me briza, kurse në dimër 18 ditë. Numri mesatar vjetor është 191 ditë. Në përputhje me motin briza fillon nga ora 9-10 paradite dhe vazhdon deri në 16-18 pasdite. Shpejtësia mesatare e saj në mesditë është 4-6 m/s. Era që ndihet në Tiranë janë Murai, Shiroku dhe Juga. Element tjetër i klimës është vranësira, që në Tiranë ka mesatare veriore 4.7 ballë. Numri mesatar i ditëve të vranëta është 89.9ditë/vit ndërsa ditë të kthjellëta janë 110.6 ditë në vit.

	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh		
Temp Max (°C)	11	12	15	18	23	28	30	30	26	22	17	12	Ø	20.3
Temp min (°C)	4	5	8	11	15	19	21	21	17	14	10	6	Ø	12.6
Reshj (mm)	91	103	99	83	63	50	31	43	118	80	146	140	Σ	1.047

4.3.4 Biodiversiteti, flora dhe fauna

Biodiversiteti është larmia e qenieve të gjalla – duke përfshirë këtu larminë e llojeve të kafshëve dhe bimëve – të geneve të këtyre organizmave, si dhe larminë e ekosistemeve tokësore, ujore dhe detare, pjesë e të cilëve janë edhe ato. Biodiversiteti ndërton strukturën e ekosistemeve dhe habitateve të cilët nga ana e tyre mbështesin burimet esenciale të gjalla, duke përfshirë faunën e egër, peshqit dhe pyjet. Është pikërisht kjo larmi biologjike e cila siguron nevojat bazë të njeriut për ushqim, strehë dhe barna mjekësore. Ai ndërton ekosistemet të cilët administrojnë dhe mirëmbajnë oksigjenin në ajër, pasurojnë tokën, pastrojnë ujin, mbrojnë nga përmbytjet dhe shtrëngatat, si dhe janë rregullatore të klimës. Biodiversiteti, po kështu mbart vlera rekreative, kulturore, shpirtërore dhe estetike. Rritja e shpejtë e shkallës së konsumit nga

ana e shoqërisë nga njëra anë, dhe rritja e popullsisë nga ana tjetër kanë çuar në një humbje mjaft të shpejtë të larmisë biologjike, erodimin e aftësisë së sistemit natyror të tokës për të ofruar në burime thelbësore dhe shërbime nga të cilat varen komunitetet njerëzore. Aktivitetet humane e kanë rritur në 1.000 shkallën e humbjeve në këtë drejtim duke e krahasuar me një shkallë normale. Për fat të keq ky proces është në vazhdim. Duke u bazuar në disa përlllogaritje të thjeshta, pothuajse çdo dy-tre lloje shpendësh në bote kërcënohen me uljen e popullatave të tyre, një në çdo tetë lloje bimësh është e rrezikuar ose kërcënuar për t'u zhdukur, një e katërta e gjitarëve, një e katërta e amfibëve dhe një e pesta e reptilëve janë të rrezikuara për zhdukje.

Tirana ka gjithashtu, një florë dhe faunë të pasur në tokë. Fauna e gjallëron këtë zonë, me elementët e saj diverse. Në të dhënat mbi florën e Tiranës dhe zonave përreth, përshkruhen rreth 1.640 lloje dhe varietete bimësh të larta duke u nisur nga kriptogramet vaskulare. Kjo shifër është mjaft e madhe po të merret parasysh sipërfaqja e tokës së botanizuar. Në fakt, mendohet që flora e gjithë Shqipërisë të ketë rreth 3.200 lloje bimësh spontane ose 29 % të llojeve të florës europiane apo 47 % të florës ballkanike. Numri relativisht i madh i llojeve bimore që gjenden në rrethinat e Tiranës, shpjegohet nga relievi shumë i ndryshueshëm me lartësi 10 - 600 m mbi nivelin e detit. Kjo bën që klima dhe formacionet bimore të ndryshojnë mjaft nga një vend në tjetrin. Në rrethin e Tiranës hasen kryesisht formacioni i makjes mesdhetare me elemente gjithmonë të blertë dhe formacioni i ahut dhe kullotat alpine, prandaj edhe variacioni i bimësisë është mjaft i theksuar dhe jep mundësi që gati gjysma e llojeve të bimëve të Shqipërisë të përfaqësohet në këtë trevë. Tokat fushore janë tepër pjellore. Ato përbëjnë bazën për zhvillimin bujqësor, prandaj sistemimi dhe mirëmbajtja e tyre paraqet rëndësi të veçantë. Për t'u përmendur është fakti se në zonat përreth Mëzezit, Kashar, rritet një mori specie bimësh medicinale me karakter dhe ndikim mjaft pozitiv në kurimin e shumë sëmundjeve. Një gjë të tillë e pohojnë dhe vetë banorët autoktonë në bisedat e tyre. Bota shtazore shqiptare ngjason me faunën e vendeve europiane mesdhetare dhe në veçanti me atë ballkanike. Kjo lidhet me kushtet e përshtatshme natyrore dhe me shumëllojshmërinë e mjediseve natyrore. Kafshët më të përhapura janë: ujku, dhelpra, çakalli, rrëqebulli, kunadhja, etj, kurse nga shpendët janë shqiponja, bufi, skifteri, trumcaku, thëllëza, mëllenja, etj. Përsa i përket zonës në studim, duke qenë një zonë relativisht e kufizuar, fauna e saj ka qenë ajo e zonës mes së cilës ndodhet. Sipas të dhënave të rezultuara nga bisedimet me të moshuarit, nëpër kodrina dikur është ndeshur edhe ndonjë kafshë e egër. Sa për zogjtë, llojshmëria e tyre nuk ka qenë e madhe. Ato kanë qenë përgjithësisht të llojit të harabelit, trumcakut, mëllenjës apo edhe ndonjë specie tjetër. Hasen gjithashtu lepuri i egër, nuse lala, bretkosa e zakonshme, breshka e zakonshme, ndërsa në pyll rriten qukapiku, laraska, bilbili, gjelza pikaloshe, etj. Në lidhje me speciet e rrezikuara për zonën në studim, përmendim shembullin e gjunjëzit bregdetar (*Ephedra distachya*). Ndërsa nga vëzhgimet e fundit, u vunë re vetëm copëza të vogla të këtij shoqërimi në zonën e Malit të Dajtit. Ky shoqërim bimor unikal për vendin tonë dhe vecanërisht bregdetin shqiptar dhe shumë i rrallë edhe në Mesdhe, gradualisht po shkon drejt zhdukjes si rezultat i pastrimit të përvitshëm dhe masave apo ndërhyrjes e aktivitetit njerëzor.

Specie invasive janë: ditrihia veshtullore (*Dittrichia viscosa*), asteri luspor (*Aster squamatus*), agava amerikane (*Agave Americana*) dhe *Acacia cyanophylla*.

4.3.5 Mjedisi biologjik

Peisazhi dhe mjedisi i zonës së projektit janë tërësisht të modifikuar, në përshtatje të urbanizimit të saj. Ndërkohë, në mjediset përreth, erozioni përbën një faktor problematik me intensitet më të lartë në zonat kodrinore përreth, ku krahas faktorëve natyrorë, është favorizuar nga aktiviteti njerëzor dhe shfrytëzimi pa kriter i inerteve nga shtretërit e lumenjve për qëllime ndërtimi. Disa nga çështjet më kryesore që duhen adresuar në këtë zonë kanë të bëjnë me rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik. Kjo, me qëllim pakësimin e ndotjes, nxitjen e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ambientit përreth, si dhe përmirësimi i mjedisit urban, periurban, hapësirat e hapura publike, etj.

4.3.6 Mjedisi Socio-Ekonomik

Me ndarjen e re administrative të vendit, Bashkia Tiranë përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Popullsia:

Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 km², densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km² ndërsa sipas Regjistrat Civil, densiteti është 682 banorë km². Pas viteve '90 popullsia në këtë zonë si dhe komunat përreth ka njohur rritje, e cila ka ardhur si për shkak natyral (lindjet), ashtu edhe si pasojë e lëvizjeve të mëdha demografike. Duke qenë e pozicionuar fare pranë qendrës së qytetit të Tiranës, zona e projektit ka tërhequr një numër të konsiderueshëm të ardhurish nga zonat më të thella. Ndërkohë që krahas qendrave të shërbimeve dhe bizneseve në rritje, janë të shumtë banorët kryeqytetas të cilët kërkojnë të ndërtojnë dhe shtëpi në territorin e kësaj Njësie. Sektori kryesor për punësim është ai privat dhe lidhet me bizneset e ndryshme, hotelet dhe restorantet në zonën e Kinostudios. Kjo gjë, sidomos vitet e fundit ka sjellë një tendencë të shtimit të vendeve të punës për gratë në këtë zonë, si dhe në fshatrat përreth. Ndërkohë, në zonë çdo vit janë kryer investime të konsiderueshme në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, si rrugë, shkollë,

ujësjellës, sistemi i kanalizimeve, etj. Në këtë zonë janë planifikuar dhe hapësirat e arsimit publik dhe privat, të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm. Çdo lagje ka qendër shëndetësore, ku ofrohet shërbimi bazë parësor, një pjesë e të cilave janë rikonstruktuar vitet e fundit.

Ekonomia

Tirana është qendra më e rëndësishme industriale në Shqipëri. Për t'u përmendur janë industria e lehtë dhe ushqimore si dhe industria ndërtimore, por edhe industria e ndërtimit të makinerive apo ajo e tekstileve dhe e përpunimit të qelqit. Si në të gjithë vendin ashtu edhe kryeqyteti i Shqipërisë ndodhet në një periudhë tranzicioni. Pas rrëzimit të diktaturës komuniste shumë vepra të dikurshme industriale kanë dalë pjesërisht jashtë përdorimit dhe nuk funksionojnë rregullisht. Por ndërkohë po merren masa të shpejta për rimëkëmbjen dhe vënien sa më të shpejtë në punë të veprave ekzistuese dhe të reja. Shumica e popullsisë janë sot të punësuar në sektorin e tregtisë dhe atë të ndërtimit, në sektorin e shërbimeve publike, atë turistik dhe si punonjës të shtetit. Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, të të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërrmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në tërësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njërën prej fazave gjatë ndërtimit të këtij muri, pasi në fazën funksionale nuk vlerësohet aktivitet me ndikim në mjedisin e zonës. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë. Efektet e mundshme nga projekti që do të implementohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme nga ky raport VNM-je. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

5.1 Ndikime të rëndësishme gjatë ndërtimit

5.1.1 Shkarkime në ujë

Nuk kemi ndotje të ujërave nëntokësore. Ujërat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të murit janë ujëra të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagjes së kantierit dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjithashtu nuk ka ndonjë sasi të konsiderueshme të ujërave gjatë fazës ndërtimore pasi sipërfaqja është e vogël dhe nuk do të jetë e nevojshme grumbullimi i ujërave të rreshjeve, pasi ato filtrojnë nën tokë. Në kantier nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore.

Punimet e pilotave do të jenë për një periudhë kohore tepër të shkurtër dhe mundësia e këtyre ujërave zvogëlohet ndjeshëm.

Tabela 8 Shkarkimet në ujë

Shkarkimet në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Para zhvillimit të veprimtarisë		Në stadin e zhvillimit të veprimtarisë	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndikimet e projektit në modelin e drenazhimit të tokës		X		X
Ndryshimet e nivelit të ujërave tokësore		X		X
Ndikimet e ndotësve mbetjeve në cilësinë e ujit		X		X
Ndikimet në hidrologjinë bregdetare		X		X

5.1.2 Emetime në ajër

Emetimet në ajër do të vijnë nga përhapja e pluhurave të materialeve të ndërtimit dhe materialit të gërmuar të sipërfaqes së tokës. Gjithashtu djegia e lëndës djegëse, që do të vijë vetëm nga automjetet që do të frekuentojnë këtë ambient. Pra mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë i ulët, kjo vjen si rezultat se mjetet rrugore që qarkullojnë janë konform normave të përcaktuara dhe të testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik të automjeteve.

Tabela 9 Shkarkimet në ajër

Shkarkimet në ajër dhe klimë	Identifikimi i ndikimit			
	Para zhvillimit të veprimtarisë		Në stadin e zhvillimit të veprimtarisë	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike dhe efekteve të tyre mjedisore		X		X
Lëndë të veçanta		X		X
Ndikimet të tjera klimatike		X		X

5.1.3 Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë do të jenë minimale, kjo për vetë faktin nuk do të përdoren apo magazinohen lëndë të rrezikshme që mund të kontaminojnë dherat. Gjithashtu ndikimet në tokë do të jenë minimale edhe sepse rikonstruksioni i murit mbajtës do të realizohet në gjurmën ekzistuese të murit. Gjatë fazës së ndërtimit të projektit kujdes i veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të

mbetjeve nga gërmimet me qëllim minimizimin e ndikimeve në tokë. Erozioni i tokës: Nisur nga nivelet e punimeve nuk parashikohet që të ketë ndikime të aspekteve të erozionit.

Tabela 10 Ndikimet në tokë

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Para zhvillimit të veprimtarisë		Në stadin e zhvillimit të veprimtarisë	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Humbje e tokave dhe kullotave		X		X
Ndryshimi i relievit të tokës		X		X
Erozioni i tokës		X		X
Kontaminim i tokës nga rrjedhjet		X		X
Kontaminim nga depozitimet e ngurta		X		X

5.1.4 Ndikimet në florë/faunë

Ndërhyrjet që do të realizohen për rikonstrukcionin e murit mbajtës nuk do të ndikojnë në florën dhe në faunën e zonës. Lëvizjet e makinerive të punës në kantierin e ndërtimit do të shkaktojnë shqetësim të papërfillshëm të habitateve të faunës. Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti i këtij objekti nuk do të ndikojë në florë dhe faunë. Sipërfaqja ekzistuese është me bimësi barishtore dhe pemë si lisi, dushku dhe pemë frutore. Në zonën e ndërtimit mund të hasen vetëm shpend të cilët i përgjigjen zonave të banuara si harabelë (*Paser domesticus*), sorra gri (*Corvus corone*), kumria (*S. decaoto*). Përveç të tjerave mund të hasen dhe zvarranikë të tillë si, zhapij me bisht të gjatë dhe zhaba. Të gjithë më sipër nuk gëzojnë status të veçantë dhe mbijetojnë më së miri në zonë.

Tabela 11 Ndikim në florën dhe faunën

Ndikime në florën dhe faunën	Identifikimi i ndikimit			
	Para zhvillimit të veprimtarisë		Në stadin e zhvillimit të veprimtarisë	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Humbje dhe dëmtimi i habitateve dhe i specieve bimore e shtazore		X		X
Ndryshime në llojshmëri dhe numër i çdo lloj kafshe, shpendi, zvarraniku		X		X
Pakësim të numrit të kafshëve të rralla në zhdukje		X		X

Pakësim të mjedisit fizik të kafshëve të gjuetisë				
Pengime në shtegtimin e kafshëve		X		X

5.1.5 Mbetjet e gjeneruara

Mbetjet e ngurta që do të gjenerohen nga ndërtimi në këtë zonë do të jenë mbetjet inerte si rezultat i gjurmimit për vendosjen e pilotave të murit mbajtës. Këto mbetje, bazuar në kërkesat e VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, do të transportohen nëpërmjet një subjekti të pajisur me licencën e kategorisë III.2.B në vendepozitim të përkohshëm të mbetjeve inerte të miratuar nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu, theksojmë se një pjesë e mbetjeve të dherave që do të gjenerohen gjatë fazës së gjurmimeve, do të përdoren si material mbushës. Mbetjet që do të gjenerohen gjatë fazës së rikonstruksionit, referuar Vendimit Nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” janë:

- 17 01 01 Beton;
- 17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06;
- 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03;
- 17 09 04 Mbetje të përzierja nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.

5.1.6 Zhurma dhe vibrime

Gjatë punimeve të rikonstruksionit do të përdoren makina të ndryshme. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën e punimeve, niveli i zhurmës do të jetë vetëm në vendin e ndërtimit. Zhurmat që do të gjenerohen do të vijnë kryesisht nga automjetet në rrugë dhe përdorimi i makinave të ndryshme transportuese, mjeteve që do të përdoren për gjurmimin e shtresave të tokës gjatë vendosjes së pilotave, zhurma e krijuar nga personeli që punon në zonë etj. Zhurma mund të krijohet nga shumë veprime ndërtimi dhe varet nga faktorë si: lloji i pajisjes, veprimet që do të kryhen dhe kushtet e makinerive të përdorura. Lloji dominues i zhurmës për shumicën e pajisjeve të ndërtimeve është motorri, zakonisht me naftë dhe pa silenciator. Makinat që gjenerojnë zhurmë do të kalibrohen dhe kontrollohen sipas standardeve të BE-së në lidhje me zhurmën e shkaktuar në mjedis. Vibrimet mund të gjenerohen gjatë fazës së gjurmimit të shtresave të tokës nga makineritë e përdorura.

5.2 Përmbledhja e impakteve potenciale negative

Për vlerësimin e impaktit në mjedis dhe në atë social, u përdor një shkallë vlerësimi me 5 gradë (për të vlerësuar madhësinë e impaktit) si dhe kombinimi me kohëzgjatjen e këtij impakti i

vlerësuar me 3 gradë (shih shkallën e vlerësimit në vijim). Për lehtësi vizuale madhësia e impaktit të vlerësuar ndryshon sipas shkallës me efektin e ngjyrave të zgjedhura.

Tabela 12 Shkalla e impaktit

+++++	Aktiviteti ka impakt të lartë pozitiv
++++	Aktiviteti ka impakt pozitiv mbi mesataren
+++	Aktiviteti ka impakt mesatar pozitiv
++	Aktiviteti ka impakt të ulët pozitiv
+	Aktiviteti ka impakt shumë të ulët pozitiv
0	Aktiviteti nuk ka impakt (neutral)
-	Aktiviteti ka impakt shumë të ulët negativ
--	Aktiviteti ka impakt të ulët negativ
---	Aktiviteti ka impakt mesatar negativ
----	Aktiviteti ka impakt negative mbi mesataren
-----	Aktiviteti ka impakt të lartë negativ

Tabela 13 Kohëzgjatja e impaktit

1	Impakti është afatshkurtër
2	Impakti është afatmesëm
3	Impakti është afatgjatë

Tabela 14 Impaktet potenciale negative

Pritësi i ndikimit	Burimi i impaktit	Kohëzgjatja, shtrirja fizike, madhësia	Kthyeshmëria në gjendjen fillestare	Shkalla e ndikimit	Nevojat për masat zbutëse
Toka					
Kontaminimi i tokës	Jo	1	+	-	Plan veprimi
Ndikime negative në karakteristika fizike të tokës	Karpenteri Betonim Vibrim	1	--	--	Plan Rehabilitimi; Ndjekja e Standarteve të punimeve
Biodiversiteti					

Dëmtim potencial i vegjetacionit	Gërmimi i shtresave të tokës përgjatë murit mbajtës; Rrjedhjet e vajrave nga makineritë e punës	1	--	--	Zbatimi i rregullores. Kushte teknike optimale të mjeteve të punës. Parandalimi i ndotjes
Fauna					
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Emetimet e gazrave dhe pluhurave. Qarkullimi i makinerive të nevojshme për realizimin e ndërhyrjeve	1	--	--	Zbatimi i rregullores. Kushte teknike optimale të mjeteve të punës. Parandalimi i ndotjes
Cilësia e ajrit					
Rritje e emetimeve të CO ₂ , CO, NO _x , SO ₂ , LN, HC(VOC)	Rritje të emetimeve në ajër nga djegia e diesel që përdoret nga makineritë por edhe nga automjetet e tjera shoqëruese	1	--	--	Përdorimi i mbulesave tek kamionët. Transporti të kryhet në oraret e trafikut të lirë. Karburanti të jetë cilësor. Kontrolli periodik i mjeteve të punës për shkarkimet. Përdorimi eficient i mjeteve të punës. Lagia e objektit gjatë punimeve të ndëtimt



Cilësia e ujërave					
Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	Ndërhyrjet për rikonstrukcion e murit mbajtës	1	-	-	Pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndësh ndotëse në mjedis
Hidrologjia					
Sistemi i kullim/shkarkimit, gjendja hidrologjike, dekantimi, erozioni	Gërmimet për rikonstrukcionin e murit mbajtës; Rrjedhjet e vajrave nga makineritë e punës	1	--	--	Sistemi i kanaleve kulluese
Përmblytjet	Jo	Jo	Jo	Jo	Terreni ka pjerrësi & ujërat e larta kullojnë në kanalin kryesor drenazhues.
Mbetjet					
Shtimi i mbetjeve urbane	Shtimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në këtë projekt	1	-	-	Ndarje të diferencuara të mbetjeve
Mbetjet inerte	Gërmimi i shtresave të tokës	1	--	--	Vend depozitim brenda kantierit. Transport në vendepozitimi n e caktuar nga Nj. A. Vendore; Ripërdorim

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË



Peizazhi					
Ndryshimi i peizazhit	Gjatë fazës së punimeve & pas përfundimit ku merr peisazhin përfundimtar	1	-	++	Duke u bazuar në projektin, peisazhi përfundimtar do të rris vlerat e zonës.
Zhurmat					
Rritje e nivelit të zhurmave	Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve dhe kamionëve	1	--	--	Mjete me kolaudim optimal. Punime gjatë orëve të përshtatshme.
Trafiku					
Trafiku	Rritje potenciale e trafikut nga lëvizja e kamionëve dhe mjeteve gjatë implementimit të projektit	1	--	--	Transporti do të kryhet gjatë orëve që shmang pikun e trafikut & në ato zona që shmang sa me shumë vendet e banuara
Ndikim social					
Ndikimi Sociale	Ndikime potenciale negative në komunitet që lidhen me impaktet negative të evidentuara	1	-	-	Do të kërkohej mirëkuptimi i gjithë banorëve për zhvillimin optimal të projektit.

Tabela 15 Tabela përmbledhëse e impakteve

Matrica përmbledhëse e impakteve (faza e kantierit)	Aktivitetet	Implantimi i kantierit	Gërmime dhe lëvizje	Sisteme të jashtme	Hegja e kantierit	Procesi i përgjithshëm
--	--------------------	-------------------------------	----------------------------	---------------------------	--------------------------	-------------------------------

Komponentët mjedisorë						
Atmosfera	Emetime të gazeve					
	Pluhura					
Mjedisi ujor						
Toka dhe nëntoka						
Zhurmat dhe vibrimet	Zhurmat					
	Vibrimet					
Ndriçimi						
Peizazhi						
Trafiku i mjeteve						
Lëndë djegëse fosile						
Energjia	Energji elektrike					
	Burime të tjera energjitike					
Mbetjet	Të riciklueshme					
	Jo të rrezikshme					
	Të rrezikshme					

Legjenda:

	Impakt potencial i lartë
	Impakt potencial mesatar
	Impakt potencial i ulët
	Impakt potencial i neglizhueshëm

Nga tabela përmbledhëse rezulton një kuadër pak a shumë jo problematik për sa u përket impakteve që krijohen nga kantieri.

5.3 Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit

Projekti “REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN “HAMDI CENOJMERI”, TIRANË, nuk do të ketë asnjë impakt në mjedisin ndërkufitar.

5.4 Ndikimet pozitive në mjedisin e zones së projektit

Ndikimet pozitive në zonën e projektit evidentohen si në mjedis dhe në aspektin social.

Tabela 16 Përmbledhje e ndikimeve positive në zonën e projektit

Ndikimi	Shkalla e impaktit
Përmirësimi i peizazhit të zonës	+++++

Punësim i banorëve të zonës gjatë ndërtimit të murit mbajtës	+++++
Rritje e aksesueshmërisë në rrugën që kalon përgjatë murit mbajtës	+++++

6. KOHËZGJATJA E MUNDSHME E NDIKIMEVE

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur fazat në të cilat do të zhvillohet projekti.

GRAFIKU PUNIMEVE

OBJEKTI: : REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA, NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË

Nr.	Emertimi Punimeve	AFATI PUNIMEVE																			
		Muaj 1					Muaj 2					Muaj 3					Muaj 4				
		1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5
1	Rrethim/ mobilizim kantier ndërtimi (sjellje pajisje, makineri, materiale)																				
2	Punime gërmimi																				
3	Punime për realizimin e pilotave																				
4	Punime për realizimin e jastekut në kokë të pilotave (themeli i murit)																				
5	Punime realizimin e murit mbajtës beton arme																				
6	Punime drenazhimi / mbushje dhe sisteme																				

7. MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

7.1 Masat kryesore lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndërtimit

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse dhe parandaluese. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të mbahen parasysh gjatë zbatimit të projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë rikonstruksionit të murit mbajtës janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblendhur si më poshtë shënuar:

- Lagia e rrugës gjatë punimeve të rikonstruksionit, dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri për të minimizuar ngritjen e grimcave të ngurta (pluhurave) në ajër.
- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Njësia Administrative Vendore dhe të vendosen kosha të mjaftueshëm për numrin e punonjësve që do të jenë pjesë e projektit.
- Të menaxhohen në mënyrë të sigurt mbetjet inerte sipas VKM nr. 575 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- Sistemi i drenazhimit të ujërave sipërfaqësorë të riparohet nga dëmtimet.

REHABILITIMI I EMERGJENCËS CIVILE, MUR MBAJTËS ME PILOTA NË RRUGËN "HAMDI CENOJMERI", TIRANË

- Të respektohen oraret e qetesisë publike dhe të mos punohet në orët e vona.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.

Tabela 17 Rekomandime për zbutjen e ndikimeve në mjedis

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të dhëna. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve
Biodiversiteti	
Dëmtim potencial i vegjetacionit	Punime me mbrojtje brenda kantierit, lagia e tokës.
Fauna	
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Drejtuesi Teknik i Punimeve ka për detyrë shpërnguljen e çdo specie që jeton brenda zonës së projektit si edhe trajtimin e tyre tek veterineri në rast aksidentesh.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të CO ₂ , SO ₂ , NO _x , PM, HC (VOC) nga djegia e karburantit të automjeteve lëvizëse	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brenda kantierit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i kantierit dhe mjeteve të punës.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit	Rehabilitim, sistemim dhe disiplinim i sitemit të kullimit (drenazhimi i ujërave sipërfaqësorë)
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në kantier	Vendgrumbullim i diferencuar. Transporti në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Administrative Vendore.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

7.2 Faza e projektimit

Masat e mëposhtme do të ndërmerren gjatë fazës së projektimit: Të gjitha fazat e nënprojekteve do të jenë të zgjedhur me kujdes për të shmangur ose minimizuar ndikimin potencial në mjedis dhe në komunitetet përreth. Punimet e ndërtimit do të jenë të vendosura, dizajnuara dhe të orientuara për të minimizuar zhvendosjet e mundshme të dherave dhe devijimin e burimeve ujore të mundshme.

7.3 Faza e ndërtimit

Në funksion të rezultateve të vlerësimeve të ndikimit, për zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis do të ndërmerren masat e mëposhtme gjatë rikonstruksionit të murit mbajtës:

- Zona ku do të kryhen gërmimet e shtresave të tokës për vendosjen e pilotave do të spërkatet me ujë periodikisht deri në tri herë në ditë (ditë të thata) dhe sidomos në qoftë se këto vende janë pranë receptorëve të ndjeshme, siç janë zonat e banimit.
- Do të përdoren automjete dhe makineri të kolauduara dhe mirëmbajtja e tyre do të bëhet në përputhje me standardet e shkarkimeve përkatëse në vendin e caktuar brenda kantierit të ndërtimit.
- Puna operationale në kantierin e ndërtimit do të jetë e planifikuar dhe e koordinuar me kujdes për të minimizuar në maksimum zhurmat e mundshme nga makineritë e ndërtimit dhe mjetet e transportit.
- Masat e dheut dhe materialet inerte të gjeneruara gjatë fazës së gërmimeve do të grumbullohen dhe do të menaxhohen me qëllim reduktimin e ndotjes.
- Lëndet apo materialet e ndërtimit do të ruhen në vende të përshtatshme dhe të mbuluara për të minimizuar emetimin e grimcave të pluhurit PM10.
- Sasia e mbetjeve të gjeneruara do të grumbullohet nga Njësia Vendore dhe/ose nga Kompanitë e Riciklimit.
- Mjetet e transportit të materialeve inerte do të jenë të mbuluara dhe gomat do të pastrohen para daljes së tyre në infrastrukturën urbane, për të shmangur shpërndarjen e grimcave të pluhurit në ajër dhe ndotjen e mundshme të infrastrukturës rrugore.
- Zona ku do të realizohet zbatimi i projektit do të pajiset me sinjalistikën përkatëse duke njoftuar për rreziqet e mundshme të sigurisë së punonjësve dhe atë publike.
- Zonat e ndjeshme ndaj erozionit të mundshmëm do të sistemohen dhe do të ndërhyhet duke ndërtuar infrastrukturën e nevojshme.
- Punonjësit do të trajnohen për rregullat e operimit në punë dhe do të njihen me termat e ndikimeve të mundshme në mjedisin e zonës, si dhe masat që do të ndërmerren për minimizimin e ndikimeve negative, me qëllim “Mbrotjen e Mjedisit” dhe aplikimin e “Parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm”.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

8.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor për këtë projekt është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm. Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

8.2 Objektivat e monitorimit

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë fazës së ndërtimit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit.
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.

Në përputhje me karakteristikat e implementimit dhe të ndërtimit të murit mbajtës dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente në fillim dhe në fund të fazës së ndërtimit të murit mbajtës:

Tabela 18 Monitorimi i parametrave mjedisore

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e Ajrit	PM ₁₀ , PM _{2.5} , SO ₂ , NO _x , CO, CO ₂	Në fillim dhe në përfundim të ndërtimit të murit mbajtës	2 herë gjatë fazës së ndërtimit	Eksperti Mjedisor

2	Emetimi i zhurmave	Niveli i zhurmave në dB	Në fillim dhe në përfundim të ndërtimit të murit mbajtës	2 herë gjatë fazës së ndërtimit	Eksperti Mjedisor
3	Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Sa herë ndodh incidenti	Oficeri i Sigurisë
4	Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit	Regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Sa herë ndodh avaria	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
5	Dëmtim i vegjetacionit apo të mbjellave	Regjistrohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Sa herë ndodh dëmtimi	Eksperti Mjedisor

9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Të zbatohet projekti i rikonstruksionit dhe përdorimi i materialeve dhe elementeve cilësore për të krijuar një pamje estetike integruar me elementë të zonës.
- Të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të gërmuara dhe me inerte.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve të dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të kryhet larja e automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasojë ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga rikonstruksioni i murit mbajtës.

- Ndikimet do të jenë kryesisht të përkohshme dhe jo të përhershme.
- Për ndikimet e identifikuara janë propozuar masat përkatëse me qëllim minimizimin dhe eliminimin e këtyre impakteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 4945 Prot.

Tiranë, më 04.09 2013

Nr. identifikues 120

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Znj. LEDIANA BOJAXHI (KARALLIU)

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDUN



LD